

KONTRATE DHURIMI KUOTE KAPITALI

(TE SHOQERISE "RS CONSTRUCTION & ENGINEERING" Sh.p.k;)

Sot, me date 05 Maj 2021 (dymije e njezete e nje), ne seline e shoqerise ne mbledhjen e ortakeve ne rend te dites ishte vendim per tjetersimin e kuotave te kapitalit:

PALET:

DHURUESI:

Z.ROLAND SINJARI, i datëlindjes 08.11.1984, shtetas shqiptar, lindur ne Lushnje mbajtes i dokumentit Letër Njoftim me Nr.035787089, person madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, zoterues i 100 % te kapitalit te shoqerise.

PERFITUESI:

ZNJ. XHENSILA SINJARI, e datëlindjes 08.01.1987, shtetase shqiptare, lindur në Korçë dhe banuese në Tiranë, me adresë Nikolla Jorga ,Nd.5,H.1,Njësia Bashkiake nr.7,1023,me dokument identifikimit Letërnjoftimi me Nr. 036892385 dhe nr. personal, dt.I75108096S, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Duke iu permbajtur dispozitave te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise neni 761 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Palet bien dakord me redaktimin e Kontrates se Dhurimit te kuotave te kapitalit te Shoqerise "RS CONSTRUCTION & ENGINEERING" Sh.p.k., sipas kushteve dhe percaktimeve ligjore te meposhtme:

DUKE QENE SE EKZISTOJNE KETO KUSHTE PARAPRAKE:

- Dhuruesi eshte pronar ne masen 100 % te kapitali ne Shoqerine "RS CONSTRUCTION & ENGINEERING" Sh.p.k;
- Pala dhuruese deklaron se eshte pronari i vetem dhe se mbi kuotat nuk ekziston ndonje barre siguruese, ashtu sic figuron edhe nga kerkimi prane Regjistrin te Barreve Siguruese;

Kjo Kontrate hartohet sipas Kodi Civil i Republikes se Shqiperise, nenet 761 dhe vijues te tij; Ligji 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar.

Secilit prej Paleve te lartpermendura do t'i referohemi si "Pale", dhe bashkerisht do t'u referohemi si "Palet".

Palet e lartpermendura bazuar ne identitetin e tyre sipas dokumenteve provuese dhe sipas Ekstraktit te nxjerre nga QKB, kane tagra te plota per te vepruar dhe per te hyre ne kete Kontrate.

Neni 1 Objekti

Ne perputhje me afatet dhe kushtet e percaktuara ne kete kontrate, Dhuruesi transferon 50 % te kapitalit te zoteruar ne shoqeri bashke me te drejtat e pronesise dhe te drejtat e tjera te lidhura me kete pjesemarrje ne drejtim te Perfituesit, duke zoteruar keshtu nga Znj. Xhensila Sinjari 50 % (pesedhjete perqind) te vleres te kapitali themeltar te shoqerise;

Neni 2 Kalimi i pronesise se ligjshme mbi kuotat

Kalimi i pronesise se ligjshme mbi kuotat nga Dhuruesi te Perfituesi realizohet me nenshkrimin e kontrates.

Kjo kontrate do depozitohet ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe ne institucionet e tjera ndaj te cilave mund te ekzistojte detyrimi per depozitim e saj. Pervec Administratorit, edhe secili nga Perfituesit ka te drejte te depozitoje kete kontrate ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe ne cdo institucion tjeter.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate, Dhuruesi zhvishet nga pronesia mbi 50% te kapitalit te shoqerise dhe mbi te drejtat qe lidhen me to dhe i gjithë kapitali i shoqerise i barabarte me 100 % (njqind perqind) transferohet si me poshte vijon:

- **Z. Roland Sinjari**, do te jete zoterues i 50% te kapitalit te Shoqerise "RS CONSTRUCTION & ENGINEERING" shpk;
- **Znj.Xhensila Sinjari**, do te jete zoterues i 50 % te kapitalit te Shoqerise "RS CONSTRUCTION & ENGINEERING" shpk;

Neni 3 Garancite

Dhuruesi ne lidhje me kuotat qe zoteron, garanton Perfituesin:

Se eshte pronar i vetem i kuotave te shitura e nuk ekzistojne mbi keto kuota te drejta, te administrimit, apo cdo lloj e drejte apo pretendimi tjeter nga cdo pale tjeter e mundshme.

Se e drejta per perfitimin e dividendit mbi kuotat e fituara ne shoqerine do te mund te ushtrohet rregullisht. Te gjitha te mirat ekonomike te perdorura nga shoqeria, te cilat jane te nevojshme ose te dobishme per aktivitetin ekonomik te shoqerise dhe per vazhdimin e pakufizuar te tyre pas dites se lidhjes se Kontrates se Dhurimit te Kuotave, veçanerisht objektet pasurore jane ne pronen e vetme e shoqerise dhe nuk jane ngarkuar me te drejta ose pretendime te te treteve.

Neni 4 Ligji i zbatueshem



Kjo kontrate rregullohet nga ligji nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar neni 761e vijues te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, Ligji "Per Qendren Kombetare te Biznesit" si dhe perkatesisht dispozitat e aktit te themelimit dhe Statutit te Shoqerise.

Neni 5

Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Palet do te perpiqen te zgjidhin me mirekuptim çdo mosmarreveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kesaj kontrate, ne te kundert juridiksioni kompetent do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor te Tirane.

Neni 6

Te ndryshme

Nenet e pergjithshme jane pjese e pandare e kesaj kontrate.

Kjo kontrate mund te ndryshoje vetem me pelqimin e te dyja paleve duke respektuar formen e shkruar.

Neni 7

Anekset e Kontrates


Kesaj kontrate i bashkelidhen si pjese perberese dhe te pandare keto dokumente qe do te quhen Anekse te Kontrates;

- Vendimi i Asamblese se Ortakeve, date 05.05.2021;
- Ekstrakt i Regjistrit Tregtar per Shoqerine "RS CONSTRUCTION & ENGINEERING" shpk
- Dokumentet e identifikimit te paleve kontraktuese.

PALET KONTRAKTUESE

DHURUESI

Roland SINJARI



PERFITUESI

Xhensila SINJARI

